

Per Qytetaret Jokomunitare:

DOKUMENTAT QE DUHET TE PARAQISNI PER PRAKTIKAT E MEPOSHTEME

REGJISTRIM ANAGRAFIK (kur vini nga vendi juaj ose nga një komunë tjetër italiane)

Për çdo antar të familjes që transferohet duhet të paraqisni këto dokumenta:

- Pashaportën
- Lejën e qëndrimit të vlefshme (nëqoftëse ka skaduar duhet të paraqisni riçevutën e rinovimit)
- Kodin fiskal
- Kartën e identitetit të lëshuar nga një komunë tjetër italiane (nëse e keni)
- Patentën italiane (edhe kopjen) nëse e keni
- Targën e autpmjeteve që keni në pronësi personale ose me të tjerë. (nëse keni automjet)
- Certifikatën e martesës dhe të lindjes të përkthyer dhe legalizuar (nëse e keni)

KINI KUJDES

RASTE TE VECANTA

a) Për qytetarët në pritje të lejës së parë të qëndrimit, mbas praktikës së bashkimit familjar:

Duhet të paraqisni kopjen e nulla osta, të lëshuar nga Prefektura dhe riçevutat postale të kërkesës për lejën e parë të qëndrimit.

b) Për qytetarët në pritje të dhënies së lejes së parë të qëndrimit: Duhet të paraqisni kopjen e nulla osta, të lëshuar nga Prefektura, kontratën e qëndrimit, të firmosur pranë sportelit Unik për Emigracionin dhe ricevutat postale të kërkesës së lejes së parë të qëndrimit.

c) Për qytetarët që kërkojnë rinjohjen e qytetarisë italiane *jure sanguinis* (për ata që kanë origjinë direkte nga qytetarë italianë që nga lindja): brenda tre muajve nga hyrja në Itali mund të kërkohet regjistrimi anagrafik duke paraqitur kodin fiskal, pashaportën me vulën e hyrjes në Itali. Në rastet kur qytetari hyn në Itali nga një vënd tjetër, antar i Schengen-it, duhet të paraqesë dhe deklaratën e pranisë të bërë në Kuesturë brenda 8 ditëve të para të hyrjes në Itali.

d) Për qytetarët në pritje të lejës për *coesione familiare* me një qytetar/re italian/e ose komunitar: duhet të paraqitet dhe riçevuta e Kuesturës për motiv familjar. Menjëherë mbasi të merrni lejën e parë, duhet ta paraqiteni në zyrën anagrafe për të specifikuar regjistrimin.



NDRYSHIM ADRESE (ndryshim brenda Komunës së Astit)

Ju duhet të paraqisni një dokument rinjohje (pashaportë, kartë identiteti ose patentë) të deklaruesit dhe për çdo antar të familjes që transferohet, këto dokumenta:

- Lejë qëndrimi të vlefshme (nëse ka skaduar, paraqisni riçevutën e rinovimit)
- Patentën italiane (edhe kopjen) nëse e keni
- Targën e mjeteve të transportit, pronë e juaja ose bashkëpronë me të tjerë, nëse keni.



RINOVIM I DEKLARIMIT TE BANESES KU JETONI **(regjistrim i lejës ose kartës së qëndrimit)**

Rinovimi i deklarimit të adresës së banesës ku jetoni (regjistrim i lejës / kartës së qëndrimit dhe deklaratë e adresës ku jetoni në këtë moment) është i detyrueshëm brenda 60 ditësh nga marrja e dokumentit të qëndrimit.

Ju duhet të paraqisni :

- Një dokument rinjohje (pashaportë, kartë identiteti, patentë) të vlefshme
- Lejë/kartë qëndrimi për ta regjistruar

KINI KUJDES:

Në rast qytetari të rritur, deklarata duhet të jetë e firmosur personalisht përpara punonjësit të sportelit. Në rast pamundësie për tu paraqitur në sportel, qytetari mund të paraqisë deklaratën e tij nëpërmjet një familiari ose ta dërgojë me fax, duke i bashkangjitur dokumentat e nevojshme.

Në rast qytetari të mitur të lindur në Asti, duhet të regjistrohet dhe leja e parë e lëshuar nga Kuestura.



KARTA E IDENTITETIT (mund të lirohet nga zero vjeç dhe çështja duhet të rezident në Itali - Vlefshmëria e ka “vetëm në Itali)

Për kartën e parë të identitetit në Itali duhet të paraqisni:

- Pashaportën
- Lejën e qëndrimit të vlefshme (ose të skaduar së bashku me riçevutën e rinovimit)

KINI KUJDES

Mund të kërkonte kartën e identitetit dhe kur jeni në pritje të lëshimit të lejes së parë për motive pune dhe motive familiare duke paraqitur pashaportën, riçevutën e postës dhe nulla osta të lëshuar nga Prefektura.

Rinovimi i kartës së identitetit – duhet të paraqisni:

- Kartën e identitetit të skaduar (në raste vjedhje ose humbje duhet të paraqisni denoncimin e faktit pranë një organi policie) dhe një dokument tjetër rinjohje të vlefshëm – patentë, pashaportë, kartë qëndrimi. Në mungesë të këtyre dokumentave duhet të paraqiteni me dy dëshmitarë, të pajisur me dokumenta të vlefshme.
- Lejën e qëndrimit të vlefshme (nëse është e skaduar duhet të keni me vete riçevutën e rinovimit).